



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1411/prot.,
2

Tiranë, më 24.06.2025

VENDIM

Nr. 31, datë 24 . 06 .2025

PËR

**“MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE NË NEVOJË QË PËRFITOJNË
PËRJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025,
TË CILËT STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimi në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 329/138 prot., datë 11.06.2025 “Mbi miratimin e listave të studentëve në nevojë që përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, faza e pestë e aplikimeve”,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën me 5 (pesë) studentëve në nevojë, që përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit, faza e pestë e aplikimeve, të cilët studiojnë në një program studimi të ciklit të parë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar është 65,001 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e një) lekë dhe përballohet nga buxheti i shtetit si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

**KRYETAR
ZAMIRA GJINI**

ANËTARË

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

Nr. 328/138 Prot.

Tiranë, më 11.06.2025

Lënda: Mbi miratimin e listave të studentëve në nevojë që përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, faza pestë e aplikimeve .

BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

E nderuar Kryetare,

Të nderuar Anëtarë të Bordit të Administrimit,

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, e ndryshuar, studentët në nevojë, të cilët studiojnë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë kanë aplikuar për përjashtim nga tarifa e shkollimit pranë komisioneve të ngritura në çdo fakultet.

Gjatë kësaj faze kanë aplikuar për përjashtim nga tarifa e shkollimit 5 (pesë) studentë të ciklit të parë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Fakultetet	Studentë që kanë aplikuar gjithsej	Studentë përfitues	Studentë jo përfitues
FSHMT	3	3	0
FMD	2	5	0
TOTAL	5	5	0

Dokumentacioni i dorëzuar nga studentët është shqyrtuar nga komisionet përkatëse në fakultete. Sa më sipër, rezultojnë 5 studentë të ciklit të parë dhe të ciklit të integruar në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të cilët plotësojnë kushtet për përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, faza pestë e aplikimeve.

Kriteret sipas së cilit studentët përfitojnë reduktim nga tarifa e shkollimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Fakultetet	Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike	Studentë, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar	Gjithsej
FSHMT	2	1	3
FMD	2	0	2
TOTAL	4	1	5

Efekti financiar është llogaritur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Fakulteti	Nr. Studentëve	Tarifa e shkollimit	Vlera e tarifës në tre muaj	Efekti financiar
I	FSHMT				
1	Infermieri e Përgjithshme	2	40,000	13,333	26,667
2	Teknikë Laboratori	1	35,000	11,667	11,667
	Totali	3			38,334
II	FMD				
1	Higjenist Dentar	2	40,000	13,333	26,667
	Totali	2			26,667
	TOTALI	5			65,001

Për sa më sipër, i propozojmë Bordit të Administrimit, miratimin e listës me 5 (pesë) studentë në nevojë, të ciklit të parë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të cilët përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, faza pestë e aplikimeve.


Efekti financiar është 65,0001 (gjashtëdhjetë e pesëmijë e një) lekë dhe përballohet nga buxheti i shtetit si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2025.

Listat analitike të studentëve ndodhen në shkresat bashkëlidhur këtij materiali:

- Shkresë nr. 1675/508 prot., datë 10.04.2025, protokolluar me Tonën me nr.329/20 datë 10.04.2025, e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike;
- Shkresë nr. 667/22 prot., datë 29.05.2025, protokolluar me Tonën me nr.329/133 datë 30.05.2025, e Fakultetit i Mjekësisë Dentare.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**ADMINISTRATOR
ARLIND BROCI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Nr. 1675 / Prot.
508

Tiranë, më 10.04.2025

Lënda: Dërgohet lista emërore e studentëve përfitues të përjashtimit nga tarifa e shkollimit, cikli i parë i studimeve Bachelor, për vitin akademik 2024-2025, faza e pestë.

ADMINISTRATORIT TË UMT

Tiranë


Bashkëlidhur ju dërgojmë listën emërore të studentëve përfitues nga përjashtimi i tarifës së shkollimit dhe procesverbalin e shqyrtimit të aplikimeve, në ciklin e parë të studimeve Bachelor, viti akademik 2024-2025, për fazën e katërt të aplikimeve, në muajin Mars 2025.


Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

ADMINISTRATOR
ALKETA MUKAVELATI



Lista e studentëve fitues për përparësiro nga trefa e shkollimit, Viti akademik 2024-2025, faza e V. të											
	Nr. Dole	Nr Proi	Emër	Mbiemër	Cikli i Studimit	Programi i Studimit	Viti	Kriteri i Aptimit	Dok. i plotëso i plotë	Mungësitë në dokumentacion	Kualifikimet/Nuk kualifikohet
Nr rendor	1	500	Gjushime	Gjara	Bachelor	Infermeri e përgjithshme	I	Student me afësi të kufizuar	I plotë		Kualifikohet
	2	501	Sara	Hala	Bachelor	Tek Laborator	I	Ndihme ekonomike	I plotë		Kualifikohet
	3	502	Rozana	Ferhati	Bachelor	Infermeri e përgjithshme	II	Ndihme ekonomike	I plotë		Kualifikohet




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Nr. 1675/ Prot.

507

Tiranë, më 10.04.2025

PROCES-VERBAL

“Mbi fazën e katërt të aplikimit për përjashtim tarife shkollimi për datat 10.03.2025 - 10.04.2025”

Në vijim të Urdhërit të Përbashkët Nr. 85, datë 24.10.2024 me Nr.1617/3 Prot. datë 24.10.2024 “Për shqyrtimin e dokumentacion-it të studentëve aplikues për përjashtim tarife shkollimi për vitin akademik 2024 -2025”, mbahet ky procesverbal, më datë 10 .04.2025 ndërmjet anëtarëve të Komisionit me përbërje si më poshtë vijon:

1. Esma Roshi
2. Anila Cake
3. Alketa Hoxha
4. Belinda Papa
5. Arkenida Peçaj

Komisioni i sipërcituar shqyrtoi dokumentat e studentëve aplikues për përjashtim tarife shkollimi duke u bazuar në kriteret e VKM Nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimi në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” e ndryshuar me VKM Nr.779, datë 26.12.2018, VKM Nr.40, datë 23.01.2019, si dhe formatit të miratuar me Vendimin Nr. 15, datë 15.02.2019 të Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë “Për miratimin e formularëve të aplikimit dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet nga studentët që përfitojnë bursë, dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” dhe Vendimin Nr.35, datë 28.09.2020 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e një ndryshimi në dokumentacionin për përjashtim nga tarifa e shkollimit, për studentët e ciklit të parë dhe të integruar, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Sipas komisionit të ngritur për pranimin e dokumentacioneve në fazën e pestë, prej datës 10.03.2025 deri më 10.04.2025, u grumbulluan në total 3 aplikime (Nr. dosje 1675 / 500 - 1675 /502).

Sa më lart, në këtë fazë u shqyrtuan 0 aplikime në total, prej të cilave u vlerësuan 3 fitues , 0 jopërfitues dhe 0 aplikantë të cilët përfitojnë me kategorinë e studentëve ekselentë .

Lista me studentët aplikues është verifikuar nga sekretaria mësimore, asnjë nga studentët e shpallur fitues nuk studion në një program të dytë studimi.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i shqyrtimit u vu re që jo të gjithë vërtetimet e ndihmës ekonomike kishin të njëjtin format (përveç atyre të marra nga portali e-albania). Sipas njësisë administrative ku janë lëshuar, disa prej tyre kanë të shënuar numër aplikimi, jo numër dosje; disa janë pa numër protokolli, por janë dokumente origjinale me firmë titullari, vulë shumë përfituese (disa kanë të cituar edhe numrin e frymëve, periudhën nga kur ka filluar familja të përfitojë etj.). Për shkak të specifikave të ndryshme që kanë, komisioni ka vlerësuar që studentët të mos penalizohen, por të konsiderohen dokumente të plota.

Sipas viteve të studimit studentët aplikantë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Bachelor	Përfitues	Jopërfitues	Total
Viti i parë	2	-	2
Viti i dytë	1	-	1
Total	3	0	3

Sipas kriterëve të aplikimit, për të tre vitet e studimit në ciklin e parë Bachelor janë paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

Kriteri	Aplikime	Përfitues	Jo përfitues	Aplikantë të dubluar (përfitues si studentë ekselence)
1. Ndihme ekonomike	2	2	-	-
2. Student me aftësi të kufizuar	1	1	-	-
Total	3	3	0	0

Listat e studentëve fitues, do të jenë bashkëlidhur shkresave përcjellëse përkatëse. Pasi lexohet procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët.

KOMISIONI:

1. Esma Roshi
2. Anila Cake
3. Alketa Hoxha
4. Belinda Papa
5. Arkenida Peçaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr. 667/ Prot

22

Tiranë më 29/05 /2025

LËNDA : Dërgohet "Lista e Përfituesve të tarifës së studimit" për vitin akademik 2024-2025, faza nr.5 (Aplikime Mars 2025)

ADMINISTRATORIT TE UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË , TIRANË

Në vijim të procedurës për përfitim tarife nga studentët aplikues për vitin akademik 2024-2025, po Ju dërgojmë Proçes-Verbalin Nr.667/20 Prot., Datë 18.04.2025, listën e përfituesve Nr. 667/21 Datë 18.04.2025 për Fazën e pestë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

ADMINISTRATOR FMD**Oltian SHERA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr 667/ Prot
20

Tiranë më 18/04 /2025

PROCES VERBAL

Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për Perjashtim Tarife 2024-2025, Faza V

(Aplikime Muaji Mars)

Date 18.04.2025

Në vijim të Urdhrit Nr. 23 prot, datë 08.11.2023 "Mbi ngritjen e grupit të punës për pranimin e dokumentacionit të studentëve në ciklin e parë bachelor, në programin e integruar të studimeve për përjashtim Tarife, për vitin akademik 2024-2025", si dhe referuar shkresës Tuaj, **Nr. 666 Prot., datë 01.11.2024**, komisioni përkatës u mbledh për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga studentët.

Nga kontrolli i dokumentacionit të dorëzuar nga studentët rezultoi si më poshtë:

Për studentët e Programit studimit Bachelor "Higjene Dentare"

1. Ergina Pura, viti 1

Studenti ka dorëzuar:

- Kartën e identitetit
- Certifikatë familjare e 3 muajve të fundit
- Vërtetim për përjashtim ndihmë ekonomike nga njësia bashkiake Pogradeci, Nr 35 prot, datë 03.03.2025, origjinal

Konkluzioni: *Studenti është përfitues* i tarifës sipas kriterit : "Student, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike"

2. Evelina Shllaku, viti 1

Studenti ka dorëzuar:

- Kartën e identitetit
- Certifikatë familjare e 3 muajve të fundit
- Vërtetim për përjashtim ndihmë ekonomike nga njësia bashkiake Has, Nr 167 prot, datë 06.03.2025, origjinal

Konkluzioni: *Studenti është përfitues* i tarifës sipas kriterit : "Student, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Konkluzione përfundimtare

Sipas gjetjeve të mësipërme, pranë FMD, kanë aplikuar për përjashtim Tarife për vitin akademik 2024-2025 . faza e pestë , 2 student përkatësisht sipas programit:

-Për Programin e studimit Bachelor“Higjene Dentare“, 2 student kanë aplikuar për përjashtimin e tarifës.

-2 student janë përfitues të tarifës për vitin akademik 2024-2025, faza 5

Në këtë proces verbal nuk janë përfshirë studentët me mesatare 9-10.

Komisioni:

Diana Hoxha

Lorena Qafmolla

Genci Kruja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr 667/21 Prot

Tiranë më 18/04 /2025

Lënda : Lista e studentëve që përfitojnë erjashtim nga tarifa për vitin akademik 2024-2025,
Faza nr. 5

Në mbështetje të proces verbalit nr. 667/20 Prot, datë 18.04.2025 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për përfitim përjashtim nga tarifa për vitin akademik 2024-2025, studentët përfitues për Fazën nr. 5, janë si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër/ kriteri	Dega në të cilën studion	Viti i shkollimit
	Studentë përfitues sipas kriterit "familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike"		
	Higjene Dentare		
1	Ergina Pura	Higjene Dentare	1
2	Evelina Shllaku	Higjene Dentare	1

Komisioni

Diana Hoxha

Lorena Qafmolla

Genci Kruja